



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.29

18 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.242, datë 12.3.2009	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim ministri	1669
Vendim i Kuvendit nr.243, datë 12.3.2009	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim ministri	1669
Vendim i KM nr.168, datë 20.2.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të nëntë autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	1670
Vendim i KM nr.171, datë 19.2.2009	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.21, datë 14.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe të treguesve fiskalë, për periudhën 2010- 2012”	1671
Vendim i KM nr.174, datë 19.2.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë universitare private “Justiniani I”	1676
Vendim i KM nr.175, datë 19.2.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë shkollës së lartë universitare private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”	1677
Vendim i KM nr.176, datë 19.2.2009	Për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë”, për përcaktimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimi, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, në vitin akademik 2008-2009	1678
Vendim i KM nr.177, datë 19.2.2009	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit “Shkolla e lartë private mesdhetare e Shqipërisë”	1679
Vendim i KM nr.178, datë 19.2.2009	Për dhënien e lejes për hapjen e kolegjit profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners”	1680
Vendim i KM nr.179, datë 19.2.2009	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.1100, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vënien në zbatim të planit afatmesëm të programit Brain Gain, për periudhën 2008-2009” ...	1681

Vendim i KM nr.180, datë 19.2.2009	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në pronësi këshillit të qarkut të Gjirokastrës	1682
Vendim i KM nr.187, datë 19.2.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Aliko, të qarkut të Vlorës	1684
Vendim i KM nr.188, datë 19.2.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dërmenas, të qarkut të Fierit	1685
Vendim i KM nr.189, datë 19.2.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Odrie, të qarkut të Gjirokastrës	1686
Vendim i KM nr.190, datë 19.2.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Bilisht, të qarkut të Korçës	1687
Vendim i KM nr.210, datë 25.2.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.1661, datë 29.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”	1689
Vendim i ERE nr.10, datë 20.2.2009	Për një ndryshim në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.8, datë 4.2.2009 “Për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të tregimit të energjisë elektrike” ...	1690
Udhëzim i KQZ nr.3, datë 5.3.2009	Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet	1691
Udhëzim i KQZ nr.4, datë 9.3.2009	Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të qendrës së votimit	1696
Vendim i KKRT nr.778, datë 30.1.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Apollon”	1699
Vendim i KKRT nr.785, datë 25.2.2009	Për dhënie licence për platformën private numerike satelitore “Digitalb” subjektit “Digitalb” sh.a.....	1700
Vendim i KKRT nr.786, datë 25.2.2009	Për dhënie licence për platformën private numerike satelitore “Supersport” subjektit “Supersport”	1700
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Arben Ukë Kukaj	1700

VENDIM
Nr.242, datë 12.3.2009

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM
MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.6081, datë 5.3.2009 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.6081, datë 5.3.2009 për shkarkimin e zotit Ylli Pango nga detyra e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.243, datë 12.3.2009

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM
MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.6082, datë 10.3.2009 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.6082, datë 10.3.2009 për emërimin e zotit Ardian Turku në detyrën e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.168, datë 20.2.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NËNTË AUTOKOLONAVE USHTARAKE
SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit të një autokolone ushtarake sllovene, të përbërë nga 3 (tri) automjete e 6 (gjashtë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 21 shkurt 2009.
 2. Lejimin e kalimit tranzit të katër autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 23 shkurt 2009, si më poshtë vijon:
 - a) Autokolona e parë përbëhet nga 2 (dy) automjete dhe 5 (pesë) trupa.
 - b) Autokolona e dytë përbëhet nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) trupa.
 - c) Autokolona e tretë përbëhet nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 32 (tridhjetë e dy) trupa.
 - ç) Autokolona e katërt përbëhet nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 32 (tridhjetë e dy) trupa.
 3. Lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 26 shkurt 2009, si më poshtë vijon:
 - a) Autokolona e parë përbëhet nga 18 (tetëmbëdhjetë) automjete dhe 41 (dyzet e një) trupa.
 - b) Autokolona e dytë përbëhet nga 4 (katër) automjete dhe 9 (nëntë) trupa.
 4. Lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 5 mars 2009, si më poshtë vijon:
 - a) Autokolona e parë përbëhet nga 8 (tetë) automjete dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) trupa.
 - b) Autokolona e dytë përbëhet nga 1 (një) automjet dhe 7 (shtatë) trupa.
 5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat e përmendura në pikën 1 dhe në shkronjën “a” të pikave 2, 3, 4 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.
 6. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat e tjera është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.
 7. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951 të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.
 8. Autokolonat sllovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
 9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.171, datë 19.2.2009**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.21, DATË 14.1.2009 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK DHE TË**

TREGUESVE FISKALË, PËR PERIUDHËN 2010- 2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.41, datë 14.1.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

1. Lidhjet 2 e 2/1, të përmendura në pikën 1, zëvendësohen me lidhjet, me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, për njësitë e qeverisjes qendrore, dhe fondet speciale të tyre jepen në lidhjen nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

[illegible]

DEFICITI	-28,176	-29,372	-34,119	-60,189	-50,011	-43,426	-43,674	-45,204
Financimi deficitit	28,176	29,372	34,119	60,189	50,011	43,426	43,674	45,204
Brendshëm	23,299	23,623	28,829	24,527	41,699	34,626	34,924	35,544
Të ardhura nga privatizimi	887	1,972	13,246	5,537	200	300	300	300
Huamarrje e brendshme	20,617	20,742	17,039	15,012	41,499	34,326	34,624	35,244
Të tjera	1,795	909	-1,456	3,978				
I huaj	4,878	5,749	5,290	35,662	8,312	8,800	8,750	9,660
Hua afatgjatë (e marrë)	9,221	9,936	9,109	38,947	15,462	17,000	18,000	19,000
Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-979	403	279	963				
Ripagesat	-3,364	-4,590	-4,098	-4,248	-7,150	-8,200	-9,250	-9,340

Lidhja nr.2/1

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

Në % të PBB

Nr.	Emërtimi	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
					Faktik	Buxheti	PBA	PBA	PBA
	Totali i të ardhurave	25.1	25.8	25.8	26.7	28.4	28.3	28.5	28.7
I.	Të ardhura nga ndihmat	0.8	0.9	0.1	0.3	0.5	0.5	0.5	0.5
II.	Të ardhura tatimore	22.6	23.1	23.4	24.3	25.9	26.0	26.3	26.4
II.1	Nga tatimet dhe doganat	16.6	17.4	18.1	18.9	19.5	19.6	19.7	19.8
1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	7.9	8.3	9.0	9.9	10.0	10.0	10.1	10.2
2	Tatimi mbi fitimin	2.4	2.5	2.2	1.7	1.8	1.8	1.8	1.8
3	Akcizat	2.3	2.6	2.9	3.0	3.8	3.8	3.9	4.0
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	0.9	1.0	1.5	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2
5	Taksa nacionale dhe të tjera	1.5	1.5	1.5	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3
6	Taksa doganore	1.7	1.6	1.0	0.8	0.5	0.4	0.4	0.4
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	1.5	1.2	1.0	1.0	1.6	1.6	1.6	1.7
II.3	Të ardh. buxh. pavarur (kontribute)	4.4	4.5	4.3	4.4	4.9	4.8	4.9	5.0
III.	Të ardhura jotimore	1.7	1.8	2.3	2.1	1.9	1.8	1.8	1.7
	TOTALI I SHPENZIMEVE	28.5	29.0	29.3	32.3	32.6	31.7	31.6	31.5
I.	Shpenzime korrekte	23.8	23.0	23.1	23.1	24.3	23.7	23.6	23.6
I.1	Personeli	6.6	6.4	6.1	6.1	5.3	5.2	5.2	5.3
I.2	Interesat	3.2	2.8	2.6	2.9	3.1	2.9	2.8	2.7
1	Të brendshme	3.0	2.6	2.4	2.6	2.7	2.5	2.4	2.2
2	Të huaja	0.2	0.2	0.2	0.3	0.4	0.4	0.4	0.4
I.3	Shpenzime operative mirëmbajtjeje	3.0	2.6	2.6	2.7	3.0	3.1	3.3	3.5
I.4	Subvencionet	0.4	0.4	0.4	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2

I.5	Mbështetje për energjinë	0.0	0.0	0.5	0.0				0.0
I.6	Shpenzime për sig.sociale dhe transferime të tjera	6.9	6.7	7.2	7.0	8.1	7.7	7.5	7.3
I.7	Buxheti lokal	2.5	2.5	2.2	2.5	3.1	3.0	3.0	3.0
I.8	Shpenzime të tjera	1.3	1.5	1.6	1.6	1.4	1.5	1.5	1.5
II.	Fondi rezervë	0.0	0.0	0.0	0.0	1.1	0.8	1.0	1.1
III.	Shpenzime kapitale	4.7	5.7	5.8	8.5	7.7	7.2	7.0	6.8
IV.	Transferta të ndryshme	0.0	0.3	0.4	0.5	-0.4	0.0	0.0	0.0
	DEFICITI	-3.5	-3.3	-3.5	-5.5	-4.2	-3.3	-3.0	-2.9
	Financimi i deficitit	3.5	3.3	3.5	5.5	4.2	3.3	3.0	2.9
	Brendshëm	2.9	2.7	3.0	2.3	3.5	2.7	2.4	2.2
	Të ardhura nga privatizimi	0.1	0.2	1.4	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0
	Huamarrje e brendshme	2.5	2.3	1.7	1.4	3.5	2.6	2.4	2.2
	Të tjera	0.2	0.1	-0.1	0.4				
	I huaj	0.6	0.6	0.5	3.3	0.7	0.7	0.6	0.6
	Hua afatgjatë (e marrë)	1.1	1.1	0.9	3.6	1.3	1.3	1.3	1.2
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-0.1	0.0	0.0	0.1	0.0			
	Ripagesat	-0.4	-0.5	-0.4	-0.4	-0.6	-0.6	-0.6	-0.6

viti 2010						viti 2011						viti 2012					
Emertimi i Institucionit Buxhetor	600-601	602-606	230-231		transferime IGSH + ISKSH	Totali	600-601	602-606	230-231		transferime IGSH + ISKSH	Totali	600-601	602-606	230-232		Totali
	pagat	tjera korente	investime/ brendshme	investime/ huaja			pagat	tjera korente	investime/ brendshme	investime/ huaja			pagat	tjera korente	investime/ brendshme	investime/ huaja	
1 Presidencia	91	78	20	0		189	95	83	20			198	105	87	20		212
2 Kuvendi	533	395	50	0		978	552	419	50			1,021	607	440	50		1,097
3 Keshilli Ministrave	182	191	20	0		393	190	202	20			412	209	212	20		441
4 Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	708	499	600	1,603		3,410	743	549	750	1,000		3,042	805	577	750	1,000	3,132
5 Ministria e Bujqesise, Ushqim dhe Mbrojt. se Konsum.	1,594	2,974	3,102	400		8,070	1,701	3,569	3,102	1,000		9,372	1,911	4,640	3,602	500	10,653
6 Ministria e Puneve Publike, Transport dhe Telekomunik.	1,092	4,774	32,411	14,364		52,641	1,161	5,943	34,796	15,300		57,200	1,303	7,902	34,796	15,300	59,301
10 Ministria e Financave	3,099	1,416	919	0	1,600	7,034	3,288	1,529	651		1,600	7,068	3,623	1,682	651		7,356
11 Ministria e Arsimit dhe Shkences	24,000	11,390	9,638	2,000		47,028	27,166	13,109	9,436	2,000		51,711	29,359	16,397	10,436	2,000	58,192
12 Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	878	701	494	0		2,073	929	771	644			2,244	1,039	809	544		2,392
13 Ministria e Shendetesise	2,596	1,861	4,801	1,000	17,958	28,217	2,956	2,432	6,345	1,000	16,880	31,313	3,706	3,622	7,062	1,000	35,133
14 Ministria e Drejtetise	3,139	1,915	806	300		6,160	3,188	2,107	856	300		6,451	3,848	2,349	856	300	7,353
15 Ministria e Puneve te Jashtme	236	1,680	120	0		2,036	243	1,848	109			2,200	261	2,032	109		2,402
16 Ministria e Brendshme	10,000	4,697	2,150	1,403		18,250	10,380	5,637	2,200	1,403		19,620	11,280	6,201	2,250	1,405	21,136
17 Ministria e Mbrojtjes	8,384	7,733	7,000	0	2,874	25,991	8,693	8,340	8,800		2,800	28,633	9,993	9,233	9,400		31,626
18 Sherbimi Informativ Shteteror	810	342	30	0		1,162	832	363	30			1,225	914	361	30		1,325
19 Drejtoria e Radio Televizionit	0	465	110	0		575	0	493	100			593	0	518	100		618
20 Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	107	48	27	0		182	114	51	27			192	127	53	27		207
22 Akademia e Shkences	36	51	3	0		90	37	54	3			94	40	57	3		100
24 Kontrolli Larte i Shtetit	214	73	10	0		297	226	78	10			314	250	82	10		342
25 Ministria e Punes, Cesht. Sociale dhe Shanseve te Bara.	1,027	19,235	267	0	15,700	36,228	1,101	22,312	285		13,730	37,428	1,236	24,394	365		38,885
26 Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	864	361	473	323		2,021	902	390	620	320		2,132	1,052	409	620	320	2,301
28 Prokuroria e Pergjithshme	900	284	60	0		1,244	928	312	60			1,300	1,016	350	60		1,426
29 Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,264	301	328	0		1,893	1,362	332	353			2,047	1,448	371	406		2,224
30 Gjykata Kushtetuese	73	27	5	0		105	78	28	5			111	88	30	5		123
31 Agjensia Telegrafike Shqiptare	72	22	5	0		99	77	24	5			106	86	25	5		116
40 Partite Politike	0	212	0	0		212	0	225	0			225	0	225	0		225
50 Instituti Statistikes	218	238	16	250		722	150	78	10			238	166	94	10		270
53 Autoriteti i Mbrojtjes Financiare	0	0	3	0		3	0	0	3			3	0	0	3		3
56 Shkolle e Magistratures	22	37	3	0		62	24	39	3			66	27	41	3		71
56 Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	800	1,750		2,550	0	0	800	1,750		2,550	0	0	800	1,750	2,550
57 Qendra Kombetare e Kinematografise	8	130	3	0		141	9	138	3			150	11	146	3		159
59 Instituti i Integritetit te Penedjekurve Politik	21	7	3	0		31	22	7	3			32	25	7	3		35
63 Keshilli i Larte i Drejtetise	53	29	4	0		86	55	30	4			89	60	32	4		96
66 Avokatit i Populit	68	22	6	0		96	72	23	7			102	80	25	7		112
67 Komisioni i Sherbimit Civil	38	15	2	0		55	46	16	2			64	56	17	2		75
73 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	72	62	8	0		142	75	665	9			749	83	65	9		157
76 Inspektorati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	65	30	4	0		99	68	32	4			104	74	33	4		111
77 Autoriteti i Konkurences	46	14	5	0		65	49	15	5			69	54	16	5		75
78 Ministria e Integritetit	84	84	16	97		281	88	91	16	97		292	97	95	16		208
82 Keshilli Kombetar Kontabilitetit	7	7	3	0		17	8	8	3			19	9	8	3		20
86 Avokatit i Prokurimeve	19	7	3	0		29	21	8	3			32	23	8	3		34
87 Institucione te tjera Qeveritare	94	180	383	0		657	97	191	200			488	102	201	200		503
88 Mbeshtetje per shoqerine civile	0	106				106	0	112				112	0	118			118
89 Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale	37	16	10			63	45	17	12			74	53	18	10		81

VENDIM
Nr.174, datë 19.2.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË
LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “JUSTINIANI I”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 pika 2 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare private “Justiniani I”, me seli në Tiranë, të programit të studimit, të ciklit të parë, me kohë të plotë, të Fakultetit të Diplomacisë.

2. Kohëzgjatja e programit të studimit, të ciklit të parë, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë 3 vite. Në përfundim të tij lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, (DNP), në diplomaci.

3. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare private “Justiniani I”, të programit të studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në fushën e drejtësisë, i cili do të realizohet me, së paku, 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite. Në përfundim të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, (DND), në drejtësi.

4. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare private “Justiniani I”, të programit të studimit “Master i nivelit të parë”, në degën “Jurist administrate”. Ky program studimi do të realizohet me, së paku, 60 kredite e me kohëzgjatje normale 1 vit. Në përfundim të këtij studimi lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP) në “Jurist administrate”.

5. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Justiniani I” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit nga personel akademik, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

6. Shkolla e lartë universitare private “Justiniani I” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1, 3 e 4 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

7. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Shkolla e lartë universitare private “Justiniani I” duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.175, datë 19.2.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë shkollës së lartë universitare private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”, me seli në Tiranë, të studimeve “Master i nivelit të parë” (MNP) në:

- a) Administrim biznesi,
- b) Financë,
- c) Kontabilitet.

2. Studimet në “Master i nivelit të parë” (MNP) synojnë arsimimin dhe trajnimin e mëtejshëm profesional. Këto programe studimi do të realizohen me së paku 60 kredite, me kohëzgjatje normale 1 vit. Në përfundim të këtyre studimeve lëshohet diploma “Master i nivelit të parë” (MNP), përkatësisht në:

- a) Administrim biznesi,
- b) Financë,
- c) Kontabilitet.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit nga një personel akademik me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

4. Shkolla e lartë universitare private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”, duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**VENDIM
Nr.176, datë 19.2.2009**

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË”, PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMI, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORE, NË VITIN

AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Ismail Qemali”, në Vlorë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë” në “Operacione industriale dhe navale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP) në “Operacione industriale dhe navale”.

2. Programi i këtij studimi realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është një vit.

3. Kuota e pranimeve në programin e studimit “Master i nivelit të parë” në “Operacione industriale dhe navale”, me kohë të plotë, në universitetin “Ismail Qemali”, në Vlorë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë 30.

4. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, në programin e studimit “Master i nivelit të parë” në “Operacione industriale dhe navale”, do të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

5. Universiteti “Ismail Qemali” në Vlorë shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind, për ata, që i kanë përfunduar këto studime pranë këtij universiteti. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, të diplomuar pranë tij.

6. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, përcaktuar nga njësitë kryesore të universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, bëhen publike paraprakisht.

7. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbrit, të shurdhët, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentët me aftësi të kufizuar, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë a të plagosur për shkak të detyrës, fëmijët e ish-të përndjekurve politikë, që fitojnë të drejtën për të ndjekur këtë program studimi, të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Në çdo program studimi “Master i nivelit të parë”, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë nuk e paguajnë tarifën e shkollimit, në vitin akademik pasardhës.

10. Kuotat e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, sipas pikës 3 të këtij vendimi, që mbeten të përealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Ky program studimi do ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.177, datë 19.2.2009

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT “SHKOLLA E LARTË
PRIVATE MESDHETARE E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” do të organizohet në tri fakultete:

a) Në Fakultetin e Shkencave Politike, me program studimi në “Shkenca politike”, në formën e studimeve me kohë të plotë;

b) Në Fakultetin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, me program studimi në “Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci”, në formën e studimeve me kohë të plotë;

c) Në Fakultetin e Shkencave Ekonomike, me program studimi në “Ekonomi”, në formën e studimeve me kohë të plotë.

3. “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” do të ofrojë programe studimi, të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 3 vite dhe në mbarim të tyre do të lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), përkatësisht, në:

a) Shkenca politike;

b) Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci;

c) Ekonomi.

4. Ngarkohet “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialiteteve.

5. “Shkolla e lartë private mesdhetare e Shqipërisë” do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. “Shkolla e lartë private mesdhetare e Shqipërisë” duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.178, datë 19.2.2009

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT “IVOCLAR VIVADENT&PARTNERS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e kolegjit profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners”, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners” do të ofrojë program studimi, të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të plotë, në “Teknik i lartë dentar”, i cili do të zgjasë 3 vite. Në mbarim të studimeve do të lëshojë “Diplomë të nivelit të parë” (DNP), në “Teknik i lartë dentar”.

3. Ngarkohet kolegji profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners” që, për programin e studimit, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Kolegji profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners” do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë, para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Kolegji profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners” duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtij programi të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.179, datë 19.2.2009

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1100, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR VËNIEN NË ZBATIM TË PLANIT AFATMESËM TË PROGRAMIT BRAIN GAIN, PËR PERIUDHËN 2008-2009”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në planin afatmesëm të programit Brain Gain, për periudhën 2008-2009, që i bashkëlidhet vendimit nr.1100, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të kreut 4.2, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Paketa nxitëse e programit Brain Gain, e parashikuar më lart, mund të reduktohet vetëm në mbështetje për pjesëmarrje në veprimtaritë akademike, në formë konferencash jashtë vendit (jo më shumë se dy në vit) për kandidatët, shumë të suksesshëm, në studimet universitare apo në karrierën e tyre profesionale, të cilët, me dëshirë, heqin dorë nga paketa nxitëse bazë. Ky grup kandidatësh do të emërtohet “Brain Gain Honor Fellow.”.

2. Shkronja “e” e kreut 7.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) Për t’u kualifikuar në skemën e paketave nxitëse, kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

i) Të jenë kthyer në Shqipëri jo më herët se data e fillimit të projektit Brain Gain (25 shtator 2006) dhe të kenë filluar marrëdhëniet e punës pas datës 1 janar 2008. Koha e kthimit në vend, e përcaktuar në këtë shkronjë, vlen edhe për kandidatët, që kanë kryer studimet e plota të doktoratës, me kohë të plotë, jashtë vendit, pa mbështetje financiare, në formë burse, nga qeveria shqiptare apo institucioni, që e ka dërguar, dhe kanë rifilluar marrëdhëniet e punës në shkollat e larta.

ii) Të kenë arritur rezultate mbimesatare në studimet e masterit, i cili ka, të paktën, 90 kredite ECTS, ku përfshihet edhe teza e masterit.

iii) Të kenë arritur rezultate mbimesatare në studimet e doktoraturës, në rastet kur vendi i punës e kërkon këtë nivel kualifikimi.

iv) T’i kenë përfunduar studimet dhe të kenë diplomën përkatëse. Diploma duhet të jetë e lëshuar nga një institucion i njohur dhe i akredituar prej organizmave akredituese, të njohura ndërkombëtarisht.

Të diplomuarit, nga programet akademike të bashkëpunimit me universitetet vendase, të tipit modular, programet akademike *on-line*, si edhe të diplomuarit nga programet akademike satelite, të ngritura jashtë vendit të origjinës së universitetit, që ka lëshuar diplomën, nuk kualifikohen për këtë skemë mbështetjeje, të arsimit të lartë.

v) Nuk duhet të jenë përfitues nga fondi i ekselencës.

vi) Nuk mund të jenë përfitues, në të njëjtën kohë, edhe nga një projekt tjetër, që mbështetet nga fonde buxhetore (p.sh. shtesa në pagë për masterin ose doktoraturën). Në këtë rast, kandidati deklaron programin, në të cilin dëshiron të kualifikohet.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.180, datë 19.2.2009**

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PRONËSI KËSHILLIT TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 6, 7, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në pronësi këshillit të qarkut të Gjirokastrës, sipas formularit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista përbëhet nga 2 (dy) fletë.

2. Kalimin në pronësi të këshillit të qarkut të Gjirokastrës vetëm të ndërtesave dhe të mjediseve, ku ky institucion shtrin veprimtarinë administrative.

3. Këshillit të qarkut të Gjirokastrës nuk i lejohet të tjetërsojë ose ndërrojë destinacionin e pronave, të përcaktuara në këtë vendim, apo t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i këshillit të qarkut të Gjirokastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë			Identifikoi: Sinan Kallfa, specialist (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Supervizoi: Arjana Konomi, specialiste (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Aprovoi: Arben Culli, kryetar (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)							
Fusha e përdorimit të pronës: administratë										
	A		B				C			
Nr. rendor	Zona kadastr. & indeksi i hartës	Nr. pasuris ë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m²)	Nga sip. totale e pronës, sa ndërtesë (m²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8542	7/39	Truall + ndërtesë	Zyra e Këshillit të Qarkut	593	370	Administratë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	
2	Gj-j -7	7/39-a	Truall + ndërtesë	Zyra e Këshillit të Qarkut	202	202	Administratë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Kati përdhes
3	Gj-j -7	7/39-b	Truall + ndërtesë	Zyra e Këshillit të Qarkut	370	370	Administratë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Kati i parë
4	Gj-j -7	7/39-c	Truall + ndërtesë	Zyra e Këshillit të Qarkut	370	370	Administratë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Kati i dytë
5	Gj-j -7	7/39-d	Truall + ndërtesë	Zyra e Këshillit të Qarkut	370	370	Administratë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Kati i tretë
6	2917	1/1	Truall + ndërtesë	Zyra Dr.Mirmb. Rrugëve Përmet	67.6	67.6	Administratë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Dr.Mirmb.rrugëve Përmet	
7	8543 Gj-j-9	8/28	Truall + ndërtesë	Zyra Dr.Mirmb. Rrugëve Gjirokastrë	5129	50	Administratë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Dr.Mirmb.rrugëve Gjirokastrë	
7/1	8543 Gj-j-9	8/28	Truall + ndërtesë	Magazina Dr.Mirmb. Rrugëve Gjirokastrë	83	83	Magazinë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Dr.Mirmb.rrugëve Gjirokastrë	
8	Gj-j -7	7/43	Truall + ndërtesë	Garazh Këshillit të Qarkut	74	74	Garazh	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	
9	92/17-D-4	1/3	Truall + ndërtesë	Garazh Dr. Mirmb. Rrugëve Përmet	54.6	54.6	Garazh	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Dr.Mirmb.rrugëve Përmet	
10	92/17-D-4	1/2	Truall + ndërtesë	Magazinë Dr. Mirmb. Rrugëve Përmet	36	36	Magazinë	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Dr.Mirmb.rrugëve Përmet	

VENDIM
Nr.187, datë 19.2.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS ALIKO, TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Aliko, të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Aliko, të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.902, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të komunës Aliko të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Aliko për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Aliko

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
17 – 18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
19 -28	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
29 -37	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
39-48, 209 – 211	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
52-58	Varrezat publike	Në pronësi
59 – 61	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
62-87	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillim ekonomik	Në pronësi
134,135,136,139,140,143, 144,146,147,148,151,152, 155,156,159,160,163,164, 166,168,169,170,173	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
137,138,141,142,145,149, 150,153,154,157,158,161,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe	Në pronësi

162,165,167,171,172,174,175	të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta)	
196 - 208	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.188, datë 19.2.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS DËRMENAS, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dërmenas, të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Dërmenas, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.95, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Dërmenas të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Dërmenas për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dërmenas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1 – 16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
17 - 29	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
30 -35	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik	Në pronësi
36 - 42	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
43 - 52	Varrezat publike	Në pronësi
56 - 84	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
85 – 99	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
137	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

130,131,132,133,134,135, 136,138,139,140,143,154 182,195,217,224,245,259 272,292,294,301	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
---	---	------------

VENDIM
Nr.189, datë 19.2.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS ODRIE, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Odrie, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Odrie, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.701, datë 19.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Odrie të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Odrie për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Odrie

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1,2,4,5,6,8,9,11,12,13,15,16	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

3,7,10,14,17,75,76,83,84,89,92,95,96 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
18-23	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
24 - 26	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
27 -29	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
30	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
31 -38	Varrezat publike	Në pronësi
39 – 44	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
45 – 62 (vetëm trojet)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
45 – 62 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
98 – 100	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
101 - 102	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.190, datë 19.2.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË BILISHT, TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Bilisht, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Bilisht, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.339, datë 20.5.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Bilisht të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Bilisht për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Bilisht

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
-------------------	------------------------------	----------------------

pronave në listën e inventarit		
1,2	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
3,4,111	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
37 - 45	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
46 - 47	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
348 -358, 121 -330	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike) rrugë vendore	Në pronësi
51 -54	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
55	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
56 – 58, 60	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
61	Varrezat publike	Në pronësi
332	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
359 - 371	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
372 - 378	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
49,6 - 36	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
50	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi

VENDIM
Nr.210, datë 25.2.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1661, DATË 29.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 2, shkronja “c”, e 26 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në

Republikës e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shtojca nr.2, që përmendet në pikën 2 të vendimit nr.1661, datë 29.12.2008 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojca II

	Buxheti 2009			
	Propozim për ndryshime në buxhetin e shërbimit spitalor			
			000 lekë	
Nr.	Institucioni dytësor	Ndryshimet në buxhetin 2009		
		Mallra e shërbime (602)		
		pakësime	shtesa	
1	Berat	4,000		
2	Dibër	4,000		
3	Fier	3,000		
4	Gjirokastër	2,000		
5	Korçë	2,000		
6	Kukës	2,000		
7	Lezhë	1,000		
8	Librazhd	1,000		
9	Lushnje	2,000		
10	Mat	1,000		
11	Skrapar	1,000		
12	Shkodër	30,000		
13	QSUT		125,000	
14	Mat.nr.1	2,000		
15	Sanatoriumi	2,000		
16	Vlorë	3,000		
	Rezervë e pashpërndarë	65,000		
	TOTALI	125,000	125,000	

VENDIM

Nr.10, datë 20.2 2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.8,
DATË 4.2.2009 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK PËR
KRYERJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 20.2.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për ndryshimin e afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.8, datë 4.2.2009 “Për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për

kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike”,
dhe konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.110, datë 16.9.2008, shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., është licencuar nga ERE-ja, për aktivitetin e ndërtimit, prodhimit, instalimit dhe shfrytëzimit të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike me erë, për një periudhë vlefshmërie prej 30 vjetësh.

- Në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, në pikën 5.2 përcaktohet një kohëzgjatje e vlefshmërisë së licencës së tregtimit të energjisë në përputhje me atë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.8, datë 4.2.2009 “Për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike”, në pikën 1, afati prej 5 vjetësh ndryshohet dhe bëhet 30 vjet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.8, datë 4.2.2009.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

UDHËZIM **Nr.3, datë 5.3.2009**

PËR MËNYRËN E NGRITJES DHE CAKTIMIT TË VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 23, pika 1, germa “b”, nenit 49, pika 1, germa b, pika 2, nenit 54, pika 2 dhe 3, nenit 59, nenit 62, pika 4, nenit 93 dhe nenit 108, pika 7, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat, që duhet të ndiqen nga organet e qeverisjes vendore, gjatë procesit të ngritjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Zona e qendrës së votimit është një zonë gjeografike, brenda territorit të një bashkie, komune ose zone zgjedhore, të përcaktuar në përputhje me Kodin Zgjedhor.

2. Harta e njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet, është harta që përgatit kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në të cilën janë vendosur edhe kufijtë e zonave të qendrave të votimit dhe që përgatitet sipas përcaktimeve të bëra në këtë udhëzim.

3. Qendër votimi është mjedisi i caktuar nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, për zhvillimin e procesit të votimit në përputhje me Kodin Zgjedhor.

4. Qendrat e votimit krijohen në:

a) ndërtesa publike, ku përfshihen: shkolla, çerdhe, kopshte, konvikte, qendra shëndetësore, qendra kulturore, qendra sportive.

b) ndërtesa private në pronësi të personave fizikë ose juridikë, vetëm me autorizim të KQZ-së, kur nuk është e mundur dhe e përshtatshme të krijohen në ndërtesa që përcakton pika 4.a e këtij neni;

c) institucione të posaçme ku përfshihen: burgjet, spitalet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se 10 ditë.

5. Ndalohet ngritja e qendrave të votimit në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike apo kandidati ose të afërmeve të tij.

Neni 3

Vendndodhja e qendrës së votimit

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim, cakton vendndodhjen e qendrës së votimit.

2. Në caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore duhet të mbajë parasysh, për aq sa është e mundur, që vendndodhja e qendrës së votimit të jetë e njëjtë me atë të përdorur në zgjedhjet pararendëse.

3. Kur në territorin e zonës së qendrës së votimit nuk ka mjedise publike të përshtatshme për QV, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i propozon KQZ-së ngritjen e qendrës së votimit në një objekt privat, duke shpjeguar arsyet përkatëse.

4. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se 10 ditë nga shpallja e listës paraprake, dërgon në KQZ dhe menjëherë pas ngritjes, në KZAZ-në përkatëse, të dhëna për numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, së bashku me numrin përkatës të zgjedhësve në listën paraprake, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, në letër dhe formë elektronike.

5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit në 10 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveçse në rastet e forcave madhore. Në këto raste, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton menjëherë KQZ-në, KZAZ-në, si dhe zgjedhësit e QV-së mbi vendndodhjen e saj të re.

Neni 4

Kritere teknike për vendndodhjen e qendrës së votimit

1. Vendndodhja e qendrës së votimit, si rregull, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë me sipërfaqe minimumi 30 m²;

b) të jetë sa më afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;

- c) të jetë mjedis me ndriçim të mjaftueshëm;
 - d) të jetë në katet e para të objekteve.
2. Qendra e votimit të jetë e pajisur me tavolina, karrige apo pajisje të tjera, të mjaftueshme për anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit.

Neni 5

- Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore merr masa për:
- a) pajisjen e QV-së me mjetet e nevojshme sipas skemës tip të planvendosjes, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - b) krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara;
 - c) vënien në dispozicion KQV-ve, të mjediseve të caktuara për qendra votimi, jo më vonë se 48 orë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 6

Ngritja e qendrave të votimit në institucione të posaçme

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ngre, në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor dhe akteve të KQZ-së, qendra votimi në institucione të posaçme, të cilët ndodhen brenda territorit të njësisë vendore përkatëse edhe kur në to ndodhen nga 15 deri 100 zgjedhës.
2. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton menjëherë KQZ-në dhe KZAZ-në për ngritjen e këtyre qendrave të votimit.

Neni 7

Përgatitja e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet dhe afati i dërgimit të saj në KQZ

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përgatit hartën e njësisë për zgjedhjet sipas kritereve teknike në lidhjen nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e listës paraprake, dërgon në KQZ hartën e njësisë përkatëse për zgjedhjet.

Neni 8


Dërgimi i numrit të QV-ve dhe numrit të zgjedhësve të listës përfundimtare

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, menjëherë me miratimin e listës përfundimtare dhe jo më vonë se një muaj nga dita e zgjedhjeve, dërgon në KQZ dhe KZAZ-në përkatëse të dhëna për numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, së bashku me numrin përkatës të zgjedhësve në listën përfundimtare, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, në letër dhe formë elektronike.
2. Në rast se kompetencat e parashikuara në këtë nen nuk ushtrohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, detyrimet, sipas këtij neni, përmbushen menjëherë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
3. Detyrat e përcaktuara në këtë udhëzim, për Bashkinë e Tiranës, ushtrohen nga kryetarët e njësive bashkiake.

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ristani



Qarku:

Rrethi:

Bashkia/njësia bashkiake/komuna:

Të dhëna për numrin e zgjedhësve në listën paraprake/përfundimtare dhe numrin e QV.

Nr	Numri i QV-ve	Numri i zgjedhësve	Vendndodhja e QV-ve
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			

Kryetari i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës
(emër, mbiemër, firmë)

Lidhja nr.1

KRITERE TEKNIKE PËR PËRGATITJEN E HARTAVE TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET

A. Bashkitë, që kanë në përbërje të vet edhe fshatra, dhe komunat duhet të përgatisin hartën e njësisë me këto elemente:

- Kufijtë administrativë të bashkisë/komunës, pozicionin e të gjithë qyteteve/fshatrave të bashkisë/komunës (qyteti/fshati që është qendër bashkie/komune të jetë më i theksuar), rrjetin rrugor që përshkon bashkinë/komunën, emërtimet e komunave fqinje.

- Në anë të hartës, të vizatohet një hartë skematike e qarkut me ndarjet e njësive vendore të qarkut, ku të vihet në dukje pozicioni i bashkisë/komunës.

- Në anë të hartës duhet të jenë listuar numrat e QV-ve me adresat përkatëse.

- Saktësia e hartës duhet të plotësojë kërkesat e saktësisë së hartave të shkallës 1:5000.

- Në rastin kur bashkia që ka në përbërje të vet edhe fshatra, dhe qyteti që është qendër bashkie ka më shumë se një qendër votimi, për qytetin qendër bashkie duhet të përgatitet hartë më vete që të plotësojë kriteret si në paragrafin B.

B. Bashkitë duhet të përgatisin hartën e njësisë me këto elemente:

- Kufijtë administrativë të bashkisë, plan-vendosjen e banesave me kodet përkatëse të numërtuar në bazë të ligjit nr.9296, datë 21.10.2004, “Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore”, emërtimin e godinave kryesore që shërbejnë për orientim në hartë si universitete (nëse ka), shkolla, spitale etj., rrjetin rrugor me emërtimet përkatëse, kufijtë e zonave të qendrave të votimit me numrat përkatës. Godinat ku ndodhen QV-të, të jenë të markuara dhe pranë të vendoset dhe numri i QV-së.

- Në anë të hartës duhet të jenë listuar numrat e QV-ve me adresat përkatëse.

- Saktësia e hartës duhet të plotësojë kërkesat e saktësisë së hartave në shkallën 1:2000.

C. Të ndryshme

- Harta duhet të sillet në KQZ në formë digjitale (format dwg, shp ose pdf) dhe në pamundësi, në letër në format A1. Kur harta është në format digjital duhet të shoqërohet edhe me hartë të printuar në format A1.

- Në emërtimin e bashkisë/komunës të jetë, veç emrit të bashkisë/komunës, ZAZ-ja dhe qarku ku përfshihet njësia, p.sh: Komuna Terpan – ZAZ Nr.2 - Qarku BERAT

- Në bashkitë me mbi 30 mijë zgjedhës, printimi i hartës të bëhet në format më të madh se

A1.

UDHËZIM
Nr.4, datë 9.3.2009

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 23 pika 1, germa “b”, nenit 36 e vijues të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të komisionit të qendrës së votimit, caktimin e rregullave për zhvillimin e mbledhjeve dhe marrjen e vendimeve.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Komisioni i qendrës së votimit është organ kolegjal. Ai përgjigjet për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit.

2. KQV-ja ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme, profesionale dhe transparente. Të drejtat dhe detyrat e KQV-së përcaktohen në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të KQZ-së.

PJESA E II
PËRBËRJA E KQV-SË

Neni 3
Ngritja e KQV-së

1. KQV-ja përbëhet nga shtatë anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KZAZ-ja vetëm për periudhën e zgjedhjeve. Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 28 qershor 2009, KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të nenit 29 të Kodit Zgjedhor.

2. Anëtarët e KQV-së propozohen nga partitë politike si më poshtë:

- a) Dy anëtarë të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- b) Dy anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
- c) Një anëtar i propozuar nga Partia Republikane Shqiptare;
- d) Një anëtar i propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;

e) Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KQV-ve nga Partia Demokratike e Shqipërisë, ndërsa në gjysmën tjetër nga Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 5 të këtij udhëzimi.

3. KZAZ-ja emëron anëtarët e KQV-së jo më vonë se pesë ditë nga paraqitja e propozimeve. Në çdo rast emërimi i tyre bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve.

4.a) KZAZ-ja emëron kryetarin e KQV-së sipas propozimit të paraqitur nga partia politike, e

cila ka tre anëtarë në komisionin e qendrës së votimit.

b) KZAZ-ja emëron zëvendëskryetarin e KQV-së sipas propozimit të paraqitur nga partia politike, e cila ka dy anëtarë në komisionin e qendrës së votimit.

5. KZAZ-ja emëron sekretarin e KQV-së me propozim të partisë politike, e cila ka paraqitur propozimin për zëvendëskryetarin e KQV-së.

Neni 4

Paraqitja e propozimeve nga partitë politike

1. Propozimet për anëtarë të KQV-së paraqiten nga partitë politike të përcaktuara në nenin 3 pika 2 të këtij udhëzimi. Partitë politike mund t'iu delegojnë degëve lokale të tyre të drejtën e propozimit për anëtarë të KQV-ve që përfshihen në territorin që mbulon dega lokale përkatëse.

2. Propozimi për anëtarët dhe sekretarin e KQV-së përmban: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, adresën e vendbanimit, si dhe arsimin e personit që propozohet.

Neni 5

Caktimi i anëtarit të shtatë të KQV-së

KZAZ-ja cakton sipas procedurës së mëposhtme, partinë politike që ka të drejtë të propozojë anëtarin e shtatë.

a) KZAZ-ja rendit duke nisur nga QV-të me numër më të vogël dhe duke vazhduar në rend rritës, të gjitha QV-të që ndodhen brenda zonës së administrimit zgjedhor.

b) Në rastet kur një QV ndahet në një ose më shumë QV të tjera, atëherë QV-të renditet pas QV-së së origjinës.

c) KZAZ-ja emëron anëtarin e shtatë të KQV-ve të renditura me numër tek, me propozim të partisë politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së.

d) KZAZ-ja emëron anëtarin e shtatë të KQV-ve të renditura me numër çift, me propozim të partisë politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ-së.

Neni 6

Emërimi i anëtarëve të KQV-së

1. KZAZ-ja, pasi konstaton se propozimet janë në përputhje me kërkesat e neneve 37 dhe 38 të Kodit Zgjedhor, emëron me vendim anëtarët e KQV-së. Për emërimin e tyre KZAZ-ja përdor modelin – 03 V “Për emërimin e anëtarëve të KQV-së”, miratuar me vendimin KQZ-së, nr.14 datë 23.2.2009.

2. Për emërimin e anëtarëve dhe të sekretarit të KQV-ve, KZAZ-ja mban parasysh të dhënat, që lidhen me ushtrimin e funksionit nga ana e tyre, ku përfshihen edhe trajnimet që ata kryejnë, si dhe masat disiplinore të marra ndaj tyre.

Neni 7

Emërimi i kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KQV-së

1. Për emërimin e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KQV-së, KZAZ-ja përdor modelin - 04 V “Për emërimin e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KQV-së”, miratuar me vendim e KQZ-së nr 14 datë 23.2.2009.

2. Sekretari i KQV-së emërohet me propozim të partisë, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KQV-së.

Neni 8

Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KQV-së

1. Anëtari dhe sekretari i KQV-së shkarkohen nga detyra sipas përcaktimeve të nenit 39 pika 1 të Kodit Zgjedhor.
2. Anëtari dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra sipas përcaktimeve të nenit 39 pika 2 të Kodit Zgjedhor.
3. Shkarkimi dhe lirimi bëhet me vendim të KZAZ-së.
4. Anëtari dhe sekretari i KQV-së, i shkarkuar me vendim të KZAZ-së, nuk mund të rizgjidhet në këtë detyrë.
5. Një kopje e masave disiplinore të marra nga KZAZ-ja, në lidhje me shkarkimin e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-ve, dërgohen në KQZ.

Neni 9

Plotësimi i vendit vakant

Kur vendi i një anëtari të KQV-së mbetet vakant, KZAZ-ja i kërkon degës lokale të partisë politike përkatëse të paraqesë propozimin për anëtarin e ri. Emërimi i anëtarit të ri bëhet sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 36, pika 4 dhe 5, të Kodit Zgjedhor.

PJESA III

Neni 10

Detyrat e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së

1. Anëtarët e KQV-së përgjigjen për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit, duke zbatuar detyrat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, si dhe vendimet e udhëzimet e KQZ-së.
2. Sekretari i KQV-së zbaton të gjitha detyrat sipas përcaktimeve të nenit 41 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimet e udhëzimet e KQZ-së.

Neni 11

Dokumenti i identifikimit

Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët dhe sekretari i KQV-së janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

PJESA IV

MBLEDHJET E KQV-SË

Neni 12

Mbledhjet dhe vendimet KQV-së

1. Mbledhjet e KQV-së janë publike.
2. Mbledhjet e KQV-së janë të vlefshme, kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të KQV-së. Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQV-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.

3. Vendimet e KQV-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën pro ose kundër, si dhe arsyetimin përkatës.

4. KQV-ja merr vendime, sipas përcaktimeve të nenit 42 pika 4 të Kodit Zgjedhor, duke përdorur modelet tip të vendimeve të miratuara nga KQZ-ja.

5. Të gjitha vendimet e KQV-së shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së.

Neni 13

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ristani

VENDIM
Nr.778, datë 30.1.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV APOLLON”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë të rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “Tv Apollon”, për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.9.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.785, datë 25.2.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR PLATFORMËN PRIVATE NUMERIKE SATELITORE “DIGITALB”
SUBJEKTIT: “DIGITALB” SHA

Në mbështetje të ligjit nr.9742, datë 28.5.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë” dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "Digitalb" sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si platformë private numerike satelitore, me afat 10-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.786, datë 25.2.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR PLATFORMËN PRIVATE NUMERIKE SATELITORE "SUPERSPORT"
SUBJEKTIT: "SUPERSPORT" SHA

Në mbështetje të ligjit nr.9742, datë 28.5.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë" dhe rregullores "Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "Supersport" sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si platformë private numerike satelitore, me afat 10-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

KËRKESË

Shtetasja Pashkë Gecaj kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë shpalljen të vdekur të djalit të saj Arben Ukë Kukaj.

KËRKUESE
Pashkë Gecaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 18.3.2009
Doli nga shtypi më 18.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “ADEL PRINT”
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë